

Nr: 448 /2018

Data: 25.07.2018

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosovo Landfill Management Company J.S.C
Kompanija za Upravljani e Deponijama na Kosevu DD

Në bazë të nenit 20 të Ligjit Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, në bazë të nenit 130 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikes dhe Qeverisjes Korporative për Ndërmarrjet Publike, në bazë të Nenit 9 të Ligji Nr. 04/L-012 për Mbrojtje nga Zjarri, në bazë të dispozitave të Kreut II Detyrimet e Punëdhënësit të Ligjit Nr. 04/L-161 për Siguri në Shëndetin në Punë, në bazë të Rregullores Nr. 05/2016 për Kërkesat Minimale për Siguri në Shëndetin e të Punësuarve me risk nga ambienti shpërthyes, si dhe në bazë të nenit 7 të Statutit të Kompanisë, Bordi i Drejtoreve të KMDK SH.A, miraton këtë:

RREGULLORE Nr. 13/2018, PËR MBROJTJE NGA ZJARRI NË OBJEKTET DHE HAPËSIRAT E KMDK SH.A

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e organizimit për mbrojtje nga zjarri, përcaktohen dhe zbatohen masat për mbrojtje nga zjarri, përshkruhen procedura në rast të zjarrit si dhe të drejtat dhe detyrat e të punësuarve të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A në zbatimin e masave mbrojtës nga zjarri dhe shpërthimet.

Neni 2

Organizimi dhe zbatimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpërthimet bëhet në bazë të Ligjit Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, Ligjit Për Mbrojtje nga Zjarri, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje, pastaj në përputhje me dispozita të veçanta të rregulloreve të brendshme për vlerësimin e rrezikshmërisë, në pajtim me Planin e veprimit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësítë natyrore dhe fatkeqësítë e tjera, si dhe konform praktikave që dalin nga Udhëzuesit.

Neni 3

Punët për mbrojtje nga zjarri janë me interes të përbashkët për KMDK SH.A si tërsi dhe ato organizohen e zbatohen njësoj në të gjitha deponitë sanitare, si dhe për të gjitha objektet dhe hapësirat e KMDK SH.A.

Neni 4

KMDK SH.A, e ka nën vëzhgim dhe kujdeset për mbrojtje nga zjarri edhe ndaj objekteve dhe hapësirave që kufizohen me objektet dhe zonat e operative me të cilat menaxhon KMDK SH.A.

Neni 5

- Të gjithë të punësuarit në KMDK SH.A pavarësisht a janë në marrëdhënie të rregullit pune ose me kohë të caktuar, janë të obliguar ta zbatojnë Planin për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësítë natyrore dhe fatkeqësítë e tjera.
- Të njëjtave obligimeve për zbatimin e Planit për mbrojtje dhe shpëtim, sipas paragrafit 1, te këtij neni u nënshtrohen edhe të gjithë klientët dhe operatoret e tjera, të cilët gjenden, veprojnë ose qëndrojnë në objektet ose hapësirat e KMDK SH.A.

KAPITULLI II
VENDOSJA ORGANIZATIVE, FUNKSIONALE DHE HAPËSINORE E KMDK SH.A

Neni 6

- 1) Selia e KMDëK SH.A gjendet në Prishtinë, ndërsa njësitë (zonat) operative se bashku me objektet, ndersa makineritë dhe hapësirat me të cilat menaxhon Kompania janë edhe Deponia sanitare në Mirash, Kastriot, Deponia sanitare ne Landovicë, Prizren, Deponia sanitare ne Velekincë, Gjilan, Deponia sanitare ne Dumnicë, Podujevë si dhe Stacioni i Transferit ne Gërlicë, Ferizaj.
- 2) Për zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri, në objektet dhe hapësirat të KMDK SH.A, formohet Shërbimi profesional, i cili përbëhet nga Komiteti për monitorim dhe emergjencia, i KMDK SH.A, Kryeshefi Ekzekutiv i KMDK SH.A, dhe të punësuar të tjerë.

KAPITULLI III
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E TË PUNËSUARVE

Bordi i Drejtoreve në KMDK SH.A

Neni 7

Bordi i Drejtoreve KMDK SH.A në zbatim të kësaj rregulloreje me propozim të KE-se shqyrton dhe miraton:

1. Rregulloret dhe aktet tjera qe ndërlidhen me dispozitat ligjore te fushës se sigurisë dhe shëndetit ne pune.
2. Propozim-kërkasat e KE-se për aprovin e mjeteve financiare të nevojshme për furnizimin e mjeteve dhe pajisjeve për mbrojtje nga zjarret.
3. Raportin për gjendjen në KMDK SH.A, për mbrojtje nga zjarri dhe për shkallën e sigurisë dhe i ndërmerr masat e nevojshme për përparimin e mbrojtjes.
4. Bën punë dhe detyra të tjera që kontribuojnë për përparimin e mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet.

Kryeshefi Ekzekutiv i KMDK SH.A

Neni 8

Kryeshefi Ekzekutiv në zbatim të kësaj rregulloreje ka këto të drejta dhe detyra:

- 1 Bën organizimin e strukturës së brendshme për mbrojtjen nga zjarret.
- 2 I shqyrton raportet, rekomandimet dhe mendimet e organeve inspektuese dhe lidhur me to sjell vendime përkatëse.
- 3 Sjell vendime për kryerjen e detyrimeve individuale nga shërbimet profesionale nga lëmi i përgatitjeve të mbrojtjes kundër zjarreve të caktuara me Ligjin për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, Ligjit Për Mbrotje nga Zjarri dhe rregulloreve/dokumenteve të tjera të KMDK SH.A.
- 4 Jep mbështetje për trajnimin e të punësuarve me rastin e kryerjes së detyrave nga lëmi i mbrojtjes së zjarreve dhe shpërthimeve.
- 5 Sjell vendim për evitimin, largimin e jokonformiteteve dhe dukurive të cilat mund të shkaktojnë zjarr ose ta rrezikojnë jetën e të punësuarve, të personave të tjerë si dhe veprimeve parandaluese qe mosdëmtimin e pasurisë.
- 6 Ngre procedurë kundër të punësuarve përgjegjës për moszbatin dhe mosrespektimin e masave për mbrojtje nga zjarret dhe shpërthimet.



Përgjegjësi për Siguri dhe Shëndet

Neni 9

Detyra dhe përgjegjësitë e Përgjegjësit për siguri dhe shëndet janë te përcaktuar me rregulloren për strukturën organizative nr 01/2017, për procedurat e punësimit strukturën organizative dhe kategorizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës por në zbatim të dispozitave te kësaj rregulloreje ka këto:

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të sigurohet se kërkesat për siguri në punë, po zbatohen.
- Të vlerësojë dhe të masë rezikun.
- Të inspektojë punishtet.
- Të hulumtojë dhe të ndërtojë statistika të incidenteve, aksidenteve dhe rasteve të sëmundjeve
- Të identifikojë fatkeqësitë e mundshme.
- Të identifikojë mënyrat e reduktimit apo eliminimit të rezikut në punë.
- Të shkruajë raporte dhe letra informuese.
- Të bëjë prezantime/trajnime tek të punësuarit.
- E përgatit planin për mbrojtje nga zjarret dhe shpërthimet dhe kujdeset për zbatimin e tij në nivel të KMDK SH.A.
- I ndjek dispozitat nga lëmi i mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet, si dhe të arriturat teknike nga kjo fushë dhe në përputhje me këtë, propozon dhe ndërmerr masa konkrete për përparimin e mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet.
- Në rast të paraqitjes së zjarrit ose shpërthimit drejtpërsëdrejti merr pjesë në analizën e zbulimit të shkaqeve për paraqitjen e zjarrit ose të shpërthimit.
- Kujdeset që gjatë fazës së projektimit, ndërtimit, rikonstruktimit/adaptimit të objekteve dhe hapësirave, me të cilat menaxhon Kompania të zbatohen dispozitat e Ligji për mbrojtje dhe shpëtim dhe dispozitat tjera nga lëmi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpërthimet.
- Të jetë në kontakt me rregulatorët shtetëror për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Të draftoj dokumentet të brendshme, rregullore, doracakë e broshura për nevojat e fushë-veprimtarisë se Kompanisë.
- Të publikojë udhëzues për të punësuarit e KMDK SH.A. se si duhet vepruar në raste të shfaqjes së rreziqeve, përfshirë, zjarret, tërmetat, vërshimet dhe fatkeqësitë e tjera natyrore apo të atyre të shkaktuara.
- Kujdeset që hapësirat e objektit si dhe hapësirat e operimit në deponi të jenë të liruara nga të gjitha sendet dhe gjërat që mund të shkaktojnë zjarr ose paraqesin pengesë për lëvizje të lirë në këto hapësira.
- Kujdeset që aparatet dhe instalimet elektrike në të gjitha objektet dhe hapësirat gjithmonë të jenë në rregull dhe të vendosura sipas rregullave.
- Kujdeset që shenjat e ndalimit të pirjes së duhanit të vendosen në vende të dukshme me qëllim të parandalimit të burimeve të zjarrit.
- Kujdeset që pajisjet dhe aparaturat zjarrfikëse të jetë në gjendje të rregullt dhe të kenë qasje dhe të vendosen në vendet e përhershme dhe ku duken lehtë.
- Kujdeset që hyrje-daljet gjithmonë të jenë të lira për daljet emergjente dhe vendkalimet për evakuimin e të punësuarve, dhe të gjithë personave të tjerë që ndodhen në hapësirat e KMDK SHA.
- Propozon ndryshime dhe plotësimet e Vlerësimit të rezikut dhe të Planit për mbrojtje dhe shpëtim si dhe eventualisht plotësim ndryshim të Rregullores për mbrojtje nga zjarri dhe shpërthimet dhe të akteve të tjera nga kjo fushë.

Shërbimi i kujdestarisë/Roja, sigurimi i KMDK SH.A

Neni 10

Shërbimi i sigurimit / roja e KMDK SH.A, në zbatim të kësaj rregulloreje i kryen këto detyra:

1. Kujdeset për sigurimin e objektit të zyrës qendrore/selisë së Kompanisë, ndërsa personat kujdestar si dhe personi i caktuar ne deponi sanitare nga Përgjegjësi për shëndet dhe siguri bën për çdo ditë verifikim vizual dhe kujdeset për rregullsinë e aparateve zjarrfikës, sistemin/rjetën e ujësjellësit, rezervarët e ujit dhe pajisjeve përfiksje të zjarrit.
2. I ndjek masat preventive për mbrojtje nga zjarret të caktuara me ligj dhe me akte të tjera nga kjo lëmi.
3. Kujdeset për të gjitha objektet dhe hapësirat e Kompanisë të jenë të pajisura me mjete përkatëse teknike përfiksje të zjarrit, varësish nga shkalla e rrezikut.

Të punësuarit tjerë

Neni 11

Të punësuarit e KMDK SHA, në zbatim të kësaj rregulloreje i kanë detyrimet si në vijim:

1. Mbajnë përgjegjësi për respektimin e masave mbrojtëse nga zjarret dhe shpërthimet në KMDK SH.A.
2. Në fushëveprimin e punës së tyre e përcjellin dhe marrin pjesë në organizimet e nevojshme për mbrojtje dhe shpëtim me çka i ruajnë të punësuarit dhe pasuritë e KMDK SH.A.
3. Angazhohen dhe marrin masa për zbatimin konsekuent të masave të caktuara dhe të dala nga urdhurat përmes mbrojtje nga zjarret dhe shpërthimet.
4. Në rast se vërehen mangësi apo defekte, njoftojnë përgjegjësin e drejtpërdrejtë/përgjegjësin për shëndet dhe siguri, apo marrin masa përlargimin me kohë të mangësive.
5. Aftësohen dhe bëjnë verifikimin e njohurive përmes mbrojtje nga zjarret.
6. E ndjekin punën e të gjitha aparateve, instalimeve dhe pajisjeve të tjera dhe çdo parregullsi e lajmërojnë te përgjegjësi.
7. Kujdesen që qasja në vendet e tyre të punës të jetë përherë e lirë.
8. Kujdesen që materiet dhe materialet e rrezikshme ti përdorin në mënyrë te përgjegjshme dhe të sigurt si dhe marrin masa përmes mbrojtje me rastin e përdorimit të tyre.
9. Obligohen të përdorin mjetet dhe pajisje mbrojtëse personale.
10. Lajmërojnë përmes paraqitjen e zjarrit ose shpërthimit dhe marrin pjesë në lokalizimin dhe evitimini e rrezikut nga ata.
11. Bëjnë evakuimin e të punësuarve sipas planit të evakuimit.
12. Pas mbarimit të kohës së punës të punësuarit janë të detyruar t'i shkyçin aparatet elektrike të cilat mund të shkaktojnë zjarr.
13. Bëjnë edhe punë të tjera të cilat kontribuojnë përpëramin e mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet.

KAPITULLI IV

APARATET, MJETET TEKNIKE DHE PAJISJET PËR MBROJTJE NGA ZJARRI

Neni 12

- 1) Personi përgjegjës për siguri dhe shëndet si dhe shërbimet e brendshme kompetente e kanë për obligim të sigurojnë mjetet dhe pajisje teknike përfiksje e zjarrit përmes objektet dhe hapësirat e KMDK SHA.
- 2) Lloji dhe sasia e aparateve apo pajisjeve përfiksje e zjarrit duhet t'i përgjigjen shkallës dhe përmasave të rreziqeve potenciale nga zjarri të analizuara në detaje përfishtë gjitha nevojat e objekteve, makinerive dhe hapësirave të KMDK SHA.

- 3) Lista e aparateve, dhe pajisjeve sipas llojit, sasisë dhe vendndodhjes do të jete e përcaktuar në **Aneksin I**, si pjese përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 13

- 1) KMDK SH.A synon të vendos në objekte sisteme përkatëse të aparateve dhe instalimeve automatike apo manuale për zbulimin dhe alarmimin e paraqitjes së zjarrit, aparate dhe instalime për detektim, si dhe sistem adekuat të pajisjeve/mjete për fikje zjarresh, aparate kundër zjarresh, dhe pajisje tjeter zjarrfikëse.
- 2) KMDK SH.A do të vendosë dhe të sigurojë një sistem të ndarë sipas objekteve dhe zonave të disponueshme me te cilat menaxhon Kompania te specifikuara sipas paragrafit 1, te nenit 6, te kësaj rregulloreje.
- 3) Sistemi i shërbimit dhe i lajmërimit bëhet përmes mjeteve te disponueshme te komunikimit për të punësuarit, vizitorët dhe klientët në rast te zjarrit eventual dhe nevojën për braktisjen e zonës, objektit – evakuimin.
- 4) Në të gjitha objektet dhe zonat do të vendosen aparatet e alarmit, shenjat udhëzuese Te informimit për largim/evakuim.

Neni 14

Aparatet, instalimet, pajisjet zjarrfikëse, mjetet për fikje, si dhe shenjat e sigurisë duhet të jenë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi si dhe me kriteret teknike sipas standardeve SK ISO EN.

Neni 15

- 1) Në rast të shfaqjes së zjarrit dhe në rrethanë, kur Kompania përballet me mungesë të mjaftueshme të sasisë se ujit si dhe shtypja e ulët e ujit, atëherë pa shtyrje në çdo moment të shfaqjes së zjarrit duhet të thërras shërbimin e zjarrfikëseve në nr. 193
- 2) Në deponitë sanitare të KMDK SHA ku gjenden lagunat do të shfrytëzohet uji i tyre përmes sistemit cirkulues dhe aggregatit si burim rezervë i cili gjendet në objekt me të cilin edhe mund të rritjet e shtypja, në rast të mungesës energjisë elektrike

Neni 16

- 1) Rrjeta e hidrantëve nuk vendoset në objekte ose në hapësira në të cilat shfrytëzimi i ujit si mjet fikjeje mund të sjell rreziqe plotësuese ose në reaksion me disa materie që shkaktojë zjarr ose shpërthim.
- 2) Inxhinieri i operatives në bashkëpunim me menaxherët e doponive, si dhe në bashkëpunim me personin përgjegjës do të projektoj dhe vendos sipas nevojë dhe mundësive hidroteknik rrjetin e hidrantëve.
- 3) Si masë parandaluese për shmangje të shpërthimit të zjarreve dhe eksplodimeve duhet të bëhet lirimi i gazrave në hapësirat e deponive, ndërsa planifikohen edhe masat e veprimit, rezervat e dheut si dhe masat e tjera të parapara me planin e veprimit

Kriteret minimale të pajisjeve teknike dhe mjeteve për fikje zjarri

Neni 17

Me kriteret minimale dhe mjetet e pajisje minimale për fikje të zjarrit në kuptimin e kësaj rregulloreje nënkuftohet minimumi i objekteve (hapësirave) për vendosjen e të punësuarve dhe minimumi i pajisjeve zjarrfikëse, i veglave dhe mjeteve për fikje të zjarrit në funksion të shpëtimit të jetës së të punësuarve dhe pasurisë nga zjarri si dhe sasia e nevojshme të rezervave të pajimeve përkatëse teknike, veglave dhe mjeteve për fikje të zjarrit të cilat i posedon KMDK SH.A .

Neni 18

KMDK SH.A siguron vende dhe hapësira adekuate për të punësuarit nëpër objekte, vendosjen e sistemeve për zbulim dhe alarmim të zjarrit, pajisjet teknike, veglat dhe mjetet tjera për fikje.

Neni 19

- 1) Pajisjet minimale tekniqe dhe mjetet për fikjen e zjarrit përcaktohen sipas shkallës së rrezikshmërisë nga zjarri, lloji i objektit apo i hapësirës që mbrohet.
 - 2) KMDK SH.A, aktualisht disponon me pajisje tekniqe si aparate për zjarrfikje, cisterna mobile, etj, të cilat do të paraqiten të listuara në Aneksin I, si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
 - 3) Krahas pajisjes dhe mjeteve zjarrfikëse dhe mjeteve për fikjen e zjarreve KMDK SH.A, duhet të sigurojë edhe pajisje dhe mjetet rezervë për fikjen e zjarreve.
 - 4) Për objektet që nuk kanë të vendosura shkallët për përdorim emergjent apo fikje zjarri, KMDK SH.A do te siguroj shkallë mobile, ndërsa për fikje zjarri, - Eko plaf për fikjen e zjarrit që përfshin njerëzit për çdo objekt nga 1-2 copë.

Neni 20

Në përputhje me procesin teknik, mënyra e projektimit dhe ndërtimit të objekteve dhe aplikimi i materialeve për ndërtim, KMDK SH.A do t'i zbatojë dhe do t'i inkorporojë sistemet, instalimet, pajisjet dhe mjetet e reja, për mbrojtje nga ziarri.

Neni 21

- Nrri 21

 - 1) Aparatet dhe pajisjet për fikje gjenden në hapësirat e objekteve te KMDK SHA, në vendet më të ndritshme, aty ku është rreziku më i madh për shfaqjen e zjarrit dhe ato të shënjohen dukshëm dhe janë të qasshme.
 - 2) Rrjeti i ujësjellësit është bërë asisoj që në rast të fikjes së zjarrit të ketë sasi të mjaftueshme të ujit.

Neni 22

Për fikjen fillestare të zjarrit KMDK SH.A, i ka aparatet dhe pajisjet minimale si dhe manualet ziarrfikse.

Nenj 23

- Nëm 23

 - 1) Zyrtari i logistikës e ka për obligim të kujdeset për afatin e përdorimit të aparateve zjarrfikëse dhe pajisjeve përfiksjen e zjarrit, përmes listimit të tyre me rastin e regjistrimit dhe te inventarizimit, shënon edhe afatet e skadimit, dhe njofton me kohë personin përgjegjës si dhe inicioi procedurat e furnizimit dhe të mirëmbajtjes.
 - 2) Çdo defekt që paraqitet te aparatet/pajisjet zjarrfikëse, duhet të mënjanohet sa më shpejt, si me mbushje, ndreqje ose remont nga ana e personave profesionistë.
 - 3) Për çdo aparat ose pajisje mbahet evidencë me shkrim.

Neni 24

- 1) Lajméruesit manualë apo automatikë të zjarrit, dritat e alarmit si dhe tokëzimi i elektriciteti, verifikohen një herë në vit ose sipas nevojës.
 - 2) Instalimi rrufepritës verifikohet për çdo vjet ose pas dëmtimit eventual.

Organizimi për mbrojtje nga zjarret

Neni 25

- 1) Komitetit për monitorim dhe emergjencat si dhe personi përgjegjës për shëndet dhe siguri, bëjnë vlerësimin e rrezikshmërisë nga zjarri duke identifikuar burimet dhe ngarkesat e pritshme të zjarrit nëpër objekte, makineri dhe hapësira të Kompanisë.

- 2) Vlerësimi i përgjithshmi rrezikshmërisë, përfshirë edhe vlerësimin e rrezikshmërisë nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera do të bëhet përmes rregullores së brendshme të KMDK SHA si akt i veçantë.
- 3) Komitetit për monitorim dhe emergjencia dhe Personi përgjegjës për shëndet dhe siguri do të përgatisin Planin për mbrojtje dhe shpëtim nga zjarri si dhe nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.
- 4) KMDK SHA do të përgatis një Udhëzues/Doracak si të veprohet në rastet e situatave të jashtëzakonshme.
- 5) Për qëllime të avancimit në zbatimit të masave preventive nga zjarri, fikja e zjarrit dhe shpëtimi i njerëzve dhe i pasurisë që rrezikohen nga zjarri, caktohet një person nga të punësuarit për mbrojtje nga zjarri dhe shpërthimet.
- 6) Akti i veprimit me kohë si dhe angazhimi i pakursyer duke u vënë në mbrojtje dhe shpëtim të njerëzve, pronës dhe pasurisë se Ndërmarrjes, por pa rrezikuar jetën personale konsiderohet si akt heroizmi dhe sakifice, për te cilën KMDK SHA në bazë të rregullores së veçantë ndanë mirënjojhe (shpërblime).

Procedura në rast të zjarrit

Neni 26

- 1) Çdo i punësuar apo person tjetër i cili do të vërejë rrezikun e drejtpërdrejtë nga paraqitura e zjarreve ose që do ta vërejë zjarrin e ka të drejtën dhe është i obliguar ta mënjanoj rrezikun, përkatesisht ta fikë zjarrin, nëse këtë punë mund ta bëjë pa rrezikuar veten ose ndonjë person tjetër.
- 2) Nëse i punësuari nuk mund ta mënjanoj rrezikun përkatesisht ta fikë zjarrin, është i detyruar që menjëherë ta njoftoj Shërbimin e zjarrfikëseve në **tel. 193** dhe duhet t'i jap të dhënat e kërkua dhe të kërkoj ndihmë nga të punësuarit të cilët janë në një afërsi të drejtpërdrejtë.
- 3) I punësuari është i detyruar t'i qaset menjëherë fikjes së zjarrit me mjetet të cilat i ka në disponim si aparatet, pajisjet, apo edhe materiale të tjera rrethanore kur bëhet fjalë për zonat e deponive etj.
- 4) Te Shërbimi zjarrfikës, zjarrin e paraqet çdo person i punësuar apo i ndodhur në objektet e KMDK SHA në tel. nr. 193 dhe në hollësi jep të dhënat për vendin e zjarrit, madhësinë e zjarrit, drejtimin e zgjerimit dhe llojin e materialit që digjet, mundësisht sasinë dhe nëse ka persona të lënduar, numri i të lënduarve.
- 5) Personi i cili thërret Shërbimin Zjarrfikës duhet të mbaj linjën telefonike të hapur derisa shërbimi të ketë marr informatat e mjaftueshme, ndaj mbylljen e bisedës telefonike e bën personi kontaktues i shërbimit emergjent etj.
- 6) Pas ardhjes së njësisë zjarrfikëse aksionin përfiks të zjarrit e udhëheq personi përgjegjës i Njësisë zjarrfikëse për mbrojtjen nga zjarret ose një person tjetër të cilin e cakton ai.
- 7) Personi që ndodhet në sigurim, personi kujdestar apo personi i ndodhura në objektet/hapësirat e KMDK SH.A, menjëherë me t'u shfaqur zjarri duhet t'i njoftoj personat të cilët gjenden në objektin e KMDK SH.A dhe e fillon aksionin përvaksim dhe shpëtim si dhe fikje të zjarrit.
- 8) Personi përgjegjës përfiks të zjarrit e udhëheq personi tjetër i caktuar ekskluzivisht për mbrojtje nga zjarrit vendos sa persona do të marrin pjesë në fikjen e zjarrit, e sa në shpëtimin e të punësuarve dhe të pasurisë së rrezikuar nga zjarri.
- 9) Po të ketë nevojë për ndihmë thirret në ndihmë Njësia e zjarrfikësve të qytetit më të afërt, dhe ndihma e shpejtë mjekësore si dhe policia.
- 10) Të punësuarit të cilët marrin pjesë në fikjen e zjarrit janë të detyruar t'u përmbahen urdhërave të udhëheqësit të aksionit përfiks e zjarrit.

- 11) Të punësuarit që nuk marrin pjesë në fijen e zjarrit janë të detyruar që përmes rrugës më të shkurtër pa panik dhe pa e penguar fikjen e zjarrit si dhe pa e penguar aktivitetin e shpëtimit ta braktisin vendin e rrezikuar nga zjarri.
- 12) I punësuari që ndodhet në hyrje të objektit, qofte person kujdestar, i sigurimit apo person i caktuar në sigurimin e objektit j'u sqaron shërbimeve emergjente të thirrura për zonën e zjarrit, ndërsa nuk lejon qasje për njerëzit e pathirrur në objektet ku ka ndodhur zjarri dhe në mënyrë aktive merr pjesë në mbajtjen e rendit dhe të sigurisë gjatë kohës sa zgjat zjarri.

Masa për mbrojtje nga zjarri dhe shpërthimi me të cilat mënjanohet, përkatësisht zvogëlohet rreziku nga zjarri dhe shpërthimet

Neni 27

Masat dhe aktivitetet e planifikuara shërbejnë për pamundësimin e paraqitjes së zjarreve e shpërthimeve, për kufizimin e zgjerimit të zjarrit, shpërthimit dhe për pasojat, zvogëlimin e rreziqeve, përmes sistemit të masave preventive dhe represive.

Neni 28

- 1) Masat preventive planifikohen dhe zbatohen sipas normativave dhe standardeve ndërtimore me rastin e projektimit dhe ndërtimit të objekteve.
- 2) Masa preventive janë aktivitetet për zbulimin, pengimin e zgjerimit fikjen e zjarreve, si dhe dhënen e ndihmës gjatë mënjanimit të pasojave.
- 3) Masat preventive përgatiten nga personi përgjegjës për shëndet dhe siguri ne bashkëpunim me komitetin për monitorim dhe emergjencë si dhe me menaxheret e deponive.

Neni 29

- 1) Si masa preventive për mbrojtje nga zjarri, në kuptimin e kësaj rregulloreje konsiderohen masat e përmendura në Planin e Veprimit në bazë të vlerësimit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitet natyrore dhe fatkeqësitet tjera.
- 2) Përmbajtja e këtij dokumentacioni për mbrojtje nga zjarret përbëhet nga një vlerësim dhe analizë e hollësishme e rreziqeve nga zjarri dhe shpërthimi, konform funksionit dhe qëllimit të përdorimit që ka objekti, pastaj varësish nga materiali i përdorur dhe konstruksionet e zbatuara, vetitë e lëndëve/materieve që shfrytëzohen në procesin e punës, vetitë e materialeve dhe materieve që janë depozituar si dhe varësish nga mënyra dhe kushtet e depozitimit dhe në bazë të kësaj parashihen dhe realizohen masat për mbrojtje nga zjarri dhe shpërthimi.

Masat e tjera kundër zjarrit

Neni 30

- 1) Me qëllim të zvogëlimit ose pengimit të rrezikut nga paraqitja dhe zgjerimi i zjarrit dhe shpërthimit KMDK SHA merr në konsideratë edhe masa të tjera në përbushje të kërkesave dhe kritereve themelore ndaj zjarrit siç janë konstruksionet ndërtimore, dyert, dritaret, shkallët dhe të hapjet tjera kundër zjarreve, si dhe qasje të shpejta për evakuim
- 2) Qasja dhe komunikimi i automjeteve të zjarrfikëse deri te secili objekt i KMDK SHA.
- 3) Për çdo ndërtim të ri apo rikonstruktimit të objekteve, ose hapësirave te reja për depozitim te mbeturinave, KMDK SH.A do të veprojë në pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, konform eurkodeve te projektimit ne varësi te destinimit te objektit.
- 4) Masat vlerësuese dhe parandaluese elektroenergetike të instalimeve elektrike me çka do të zvogëlohen rreziqet e paraqitjes dhe zgjerimit të zjarrit ose shpërthimit dhe masat termoenergetike.

- 5) Çdo objekt ka tabelën e vet elektrodispeçere prej nga, me ndihmën e ndërprerësit kryesor ndërpritet hyrja në të gjitha tabelat dispeçere, në tabelat komanduese dhe të konsumatorëve nëpër objekte.
- 6) Tabelat kryesore elektrodispeçere janë furnizuar me ndërprerës automatikë për ta ndërprerë hyrjen e energjisë elektrike.
- 7) Ndërprerësit vendosen në vende të përshtatshme për ndërprerje të shpejtë dhe të lehtë nga ana e të punësuarve në rast të zjarreve ose të ndonjë rreziku tjetër.
- 8) Në objektet dhe hapësirat e rrezikut nga zjarri, aty ku ka aparate, pajisje, instalime e të cilat mund të krijojnë elektricitet, vendosen tokëzimet.
- 9) Instalimet elektrike, sistemet e ventilimit, kondicionimit dhe të ngrohjes, sistemi rrufepritës si dhe instalimet të tjera të ngashme duhet patjetër të vendosen në përputhje me normativat dhe standartet teknike dhe të mbahen në gjendje të rregullt.
- 10) Të gjitha objektet dhe hapësirat detyrimisht duhet të sigurohen me ajrosje natyrore ose artificiale.
- 11) Të gjitha objektet të sigurohen me instalime rrufepritësish për mbrojtje nga zbrazjet atmosferike në përputhje me dispozitat teknike për rrufepritës.
- 12) Me qëllim të zvogëlimit të rrezikut që nga paraqitja/shfaqja dhe zgjerimi i zjarrit, parashihen masa të përgjithshme preventive në formë të shenjave për alarm, shenjave të rrezikut dhe të ndalimeve, shenja për caktimin e drejtimit të lëvizjes dhe daljet me rastin e evakuimit, këto shenja vendosen në vende të dukshëm nëpër objekte.

Neni 31

Për sigurimin dhe furnizimin e vazhdueshëm me energji elektrike në nyjet kritike siç janë: pompat për sigurimin e ujit, ndriçimi, sistemet për zbulim automatik dhe për lajmërimin e zjarrit etj. KMDK SH.A siguron burime alternative te energjisë me gjenerator.

Neni 32

Instalimet, konektorët, aparatet tjera rregullisht mbahen në gjendje të rregullt në përputhje me dispozitat teknike dhe me udhëzimet e prodhuesit si dhe me rregullat e praktikës teknike.

Masat e veçanta për mbrojtje nga zjarri

Neni 33

- 1) Në kuadër të masave për mbrojtje nga zjarret dhe shpërthimet përfshihen:
 1. Përzgjedhja e materialeve, aparateve, instalimi dhe konstruksioni i objekteve me të cilët do të pengohet zjarri dhe mundësia e zgjerimit të zjarrit dhe shpërthimeve, si dhe të reduktohet në minimum rreziku.
 2. Kujdesi në mirëmbajtjen e hapësirave të papenguara për qasje të lehtë nëpër objekte.
 3. Sigurimi i sasive të mjaftueshme të ujit, dheut ose të mjeteve dhe aparateve të tjera përfikjen e zjarrit.
 4. Ndalimi i përdorimit të zjarrit të hapur dhe u burimeve të tjera të ndezjes nëpër objekte dhe në hapësirat e KMDK SH.A, për shkak të së cilave mund të shkaktohet zjarr ose shpërthim.
 5. Kufizimi dhe kujdesi ne përdorimin e stufave elektrike, ngrohëseve, stufave me gaz dhe trupa të tjera ngrohës nëpër objekte si dhe kufizimi i depozitimit te materialeve që ndizen lehtë në hapësirat e punës dhe ne deponitë e KMDK SH.A, materiet e të cilave mund të shkaktojnë zjarr ose shpërthim.
 6. Kujdesi në trajtimin e mbeturinave përmes mbulueshmërisë dhe kompaktimit të tyre.
 7. Mirëmbajtja e sistemit për lirimin e gazrave, përmes gypave dhe tubacioneve si masë parandaluese për eksplodime/shpërthime.

- 2) Në çdo objekt dhe në çdo kat në vende të dukshme të vendoset, Udhëzimi për evakuim për braktisjen e sigurt të objektit.
- 3) KMDK SH.A në bazë të planit të veprimit për mbrojtje nga zjarri si dhe nga përvojat e trajnimeve do të organizohet në atë mënyrë që të reduktohet në minimum rreziku nga zjarri dhe shpërthimi.
- 4) Në objektet dhe hapësirat e KMDK SH.A ku zhvillohet puna administrative duhet të vendosen pajisje për zbulimin dhe aparate përfiksje e zjarrit.

Neni 34

- 1) Aparatet, veglat dhe pajisjet përfiksje e zjarrit të cilat nuk janë të vendosura, duhet të ruhen në vende ku qasja është e lehtë dhe të janë të dukshme dhe në vende të caktuara për këtë qëllim dhe këto të ruhen në gjendje të mirë.
- 2) Përdorimi i aparateve zjarrfikëse është i kufizuar dhe mund të shfrytëzohen vetëm përfiksje e zjarrit ose përfiksje e tij punësuarve. Në të gjitha rastet tjera aparatet dhe pajisjet zjarrfikëse nuk guxojnë të shfrytëzohen.
- 3) Aparatet elektrike dhe aparatet tjera që mund të shkaktojnë zjarr ose shpërthim duhet të shkyçen gjithmonë pas mbarimit të orarit të punës.

KAPITULLI V MASAT KUNDËR ZJARRIT NË DEPONI

Neni 35

- 1) Mbrotja nga zjarri dhe veprimet që duhet të ndërmerrin në rast të zjarrit duhet të bëhen në përputhje me këtë rregulloret si dhe me aktet e përgjithshme të Kompanisë, në veçanti sipas elaboratit përmbrrojtjen nga zjarri.
- 2) Elaborati i cekur në paragrafin 1 të këtij nenit, duhet të hartohen nga i punësuar përsigurinë dhe shëndetin në punë apo nga ndonjë ekspert/profesionisti i jashtëm dhe ato duhet të janë në dispozicion të Bordit Menaxhues, Kryeshefit Ekzekutiv, Drejtorit të Operatives si dhe te menaxherëve të deponive.
- 3) Pjesa udhëzuese grafike, përmbrrojtje nga zjarri e cila gjendet brenda elaboratit, po e njëjta duhet të jetë e shkëputur dhe e zmadhuar në përmasa të mjaftueshme fizike përdukje dhe lexim dhe të vendoset në muret e objekteve të çdonjërës deponi përfshirë edhe selinë e Kompanisë.

Neni 36

- 1) Punëkryesit, kontraktorët e punimeve ose ofruesit e shërbimeve gjithashtu janë të detyruar të zbatojnë masat e mbrojtjes nga zjarri, dhe po ashtu në vazhdimësi çdo ditë të punës janë përgjegjëse për parandalimin e zjarrit, por në rast të zjarrit, janë përgjegjës përtë marrë të gjitha masat e nevojshme në kryerjen e punimeve sanuese dhe të riparimit, në zonën e burimit apo në zonën e deponisë.
- 2) Për çdo situatë, incident apo aksident, punëkryesit/kontraktoret e punimeve ose ofruesit e shërbimeve janë të detyruar të raportojnë me shkrim menjëherë Menaxherin e Kontratës/Drejtorin e Operative, dhe jo më vonë se 24 orë.
- 3) Dispozitat nga paragrafët 1), dhe 2) i këtij nenit, janë pjesë përbërëse e detyrimeve kontraktuale në mes të KMDK SH.A. dhe kontraktorit përfshirë apo shërbim.

Aparatet e nevojshme të zjarri përforsim ne Deponi

Neni 37

- 1) Deponitë duhet të janë të pajisura me aparate përfiksje e shuarje dhe kontroll te zjarrit, pajisje përfiksje e tijera mbrojtëse dhe të sistemeve instaluese, si dhe shenjat dhe tabelat përfshirë ndalesa dhe rreziqet.

- 2) Çdo deponi duhet të furnizohet me:
 1. pajisje portative me peshe 6 kg e cila do të jetë e vendosur në automjete/makineri
 2. aparati me peshe 9 kg dhe 50 kg i vendosur ne objekteve te gatshme për qasje ne sektorët e punës, apo lokacionet e shfaqjes se zjarrit,
 3. rezervuar statik i ujit me kapacitet 2000 litra ne Stacioni i Transferit ne Gërlicë,
 4. cisterne mobile e ujit me kapacitet 5000 litra, dhe
 5. sasi e nevojshme e dheut për intervenim të shpejtë me mbulueshmëri në vatrën e zjarrit
- 3) Forma, përbajtja, si dhe sasia e shenjave për informim, ndalesa, kufizime, dhe përrreziqe e cekur ne paragrafin 1), te këtij neni do të rregullohen me akt të veçantë.

Neni 38

- 1) Në rast të shpërthimit të zjarri në zonën e deponive është obligative që menjëherë të telefonohet shërbimi i zjarrfikëseve dhe i emergjencave, ndërsa deri në arritjen e shërbimit, punëtorët e deponisë duhet të përpilen për ta shuar vet ose për ta vënë nën kontroll zjarrin, duke përdorur pajisjet dhe mjetet disponues kundër zjarrit.
- 2) Një sasi e dheut duhet te jete ne dispozicion te deponisë për te vepruar shpejt ne mbulimin e paraqitjes se vatrës së zjarrit.
- 3) Punonjësit e deponise e kane per detyre që për çdo shpërthimit të zjarrit të lajmërojnë menjëherë Menaxherin/Drejtorin, Udhëheqësin e Njësisë se kontrollës se brendshme dhe Drejtorin e Operatives.

KAPITULLI VI

MËNYRA E NJOHJES SË TË PUNËSNDARVE ME RREZIQET NGA ZJARRI DHE SHPËRTHIMI NË VENDIN E PUNËS

Neni 39

- 1) KMDK SH.A do t'i informojë të gjithë të punësuarit dhe të punësuarit e rindë me rreziqet dhe masat preventive për mbrojtje nga zjarri dhe shpërthimi, si dhe të drejtat e detyrimet nga aspekti i mbrojtjes nga zjarret dhe shpërthimet.
- 2) Njohjen me rreziqet, masat e veprimit si dhe edukimin e të punësuarve e organizon dhe e zbaton personi përgjegjës për shëndet dhe siguri i KMDK SH.A, me një plan të caktuar dhe të miratuar paraprakisht nga komiteti për monitorim dhe emergjencia dhe organet udhëheqëse te Kompanisë.
- 3) Njohja dhe edukimi nga aspekti i mbrojtjes nga zjarri është e drejtë dhe detyrim i çdo të punësuari dhe është në interes të KMDK SH.A.
- 4) Njohja e të punësuarit me rreziqet bëhet në mënyrë të tillë, që personi përgjegjës për shëndet dhe siguri apo zyrtari tjetër nga zyra e personelit të KMDK SHA, është i detyruar që të punësuarit t'ia japë në shqyrtim të gjitha rregulloret, udhëzuesit si dhe dispozitat e tjera ligjore me të cilat rregullohet kjo fushë.
- 5) Përgjegjësi për shëndet dhe siguri në KMDK SH.A është i detyruar që para se të filloj në vendin e punës i punësuarit i/e ri/re, që ta njoftoj verbalisht për rreziqet nga paraqitja e zjarrit dhe shpërthimit si dhe t'ia bëjë me dije të drejtat dhe detyrimet e tij.
- 6) Përgjegjësi për shëndet dhe siguri i KMDK SH.A, poashtu e njofton lidhur me rreziqet si dhe pasojat të cilat mund të paraqiten nga përdorimi i gabuar ose nga përdorimi e papërgjegjshëm dhe jo i drejtë i pajisjeve dhe me mjetet e punës.

KAPITULLI VII

MËNYRA E AFTËSIMIT E TË PUNËSUARVE PËR PJESËMARRJE NË FIKJEN E ZJARREVE, PËRDORIMIN E APARATEVE, PAJISJEVE TEKNIKE DHE MJETEVE PËR FIKJEN E ZJARRIT

Neni 40

- 1) Të punësuarit në KMDK SH.A, aftësohen dhe trajnohen për:
 1. zbatimin e masave preventive dhe aktive për mbrojtje nga zjarri,
 2. fikjen e zjarreve fillestare dhe procedurën në rast zjarri, si dhe
 3. shpëtim dhe evakuim.
- 2) Trajnimi bëhet përmes ligjëratave teorike dhe praktike, ndërsa pastaj bëhet edhe testim i çdo të punësuari në vend të punës të cilët pas njojurive pozitive marrin vërtetim /certifikatë se është aftësuat nga fusha e mbrojtjes nga zjarret.
- 3) Gjatë trajnimit duhet të përfshihet materia në vijim:
 1. konditat për djegie dhe fikje;
 2. masat preventive për mbrojtje nga zjarret dhe rreziqet në vend të punës,
 3. pajisjet dhe mjetet aparatet zjarrfikëse, dhe
 4. shpëtimi dhe evakuimi
- 4) Njouria nga lëmenjtë e sipërpërmendur verifikohet njëherë në dy vjet.
- 5) Të punësuarit të janë të aftësuar për realizimin e masave preventive për mbrojtje nga zjarret dhe mënyrën për përdorimin e aparateve zjarrfikës.
- 6) Krahas aftësimit për fikje, të punësuarit janë të aftësuar edhe për evakuimin e personave nga objektet dhe hapësirat e KMDK SH.A në rast të zjarrit etj.
- 7) Në objekte dhe në hapësirat e KMDK SH.A vendosen tabelat për udhërrëfime për dalje për evakuimin më të shpejtë të njerëzve.
- 8) Në rast të paraqitjes së zjarrit menjëherë të fiket rryma elektrike nga çelësi kryesor.

KAPITULLI VIII

ORARI DHE KOHA E KONTROLLIMIT TË APARATEVE, PAJISJEVE TEKNIKE DHE MJETEVE PËR FIKJEN E ZJARRIT

Neni 41

- 1) Varësisht nga karakteristikat konstruktuese të materialeve ndërtimore që shfrytëzohet në punë dhe varësisht nga llojet e mbeturinave që deponohen, parashihet edhe natyra llojet e mundshme të zjarrit, ndaj kjo përcakton edhe llojin e pajisjeve, aparatet për fikjen fillestare të zjarrit që duhet vendosur.
- 2) Proces i fikjes është një veprim me mjetet të caktuara derisa të ndërpritet djegia e materies së ndezur, ndërsa efikasiteti varet shumë nga zgjedhja e drejte e mjeteteve adekuate.
- 3) KMDK SH.A, është i pajisur me mjetet elementare për fikjen e zjarreve ne fazën e hershme te shfaqjes se zjarrit dhe për përmasa jo te mëdha te zjarrit, deri në intervenimin e shërbimit emergjent zjarrfikës.
- 4) Lloji dhe sasia e pajisjes dhe mjeteteve të domosdoshme për fikje të zjarreve caktohen në bazë të normativave teknike dhe në bazë të vlerësimit të shkalles së rrezikshmërisë nga zjarrri dhe shpërthim.
- 5) Personi përgjegjës për shëndet dhe siguri, njëkohësisht është edhe bartësi për mbrojtje nga zjarret në kompetencat e të cilit është zgjedhja e pajisjes dhe mjeteteve, mban llogari me rastin e zgjedhjes së pajisjes dhe që ato t'u përgjigjen standardeve që janë në zbatim.
- 6) Për fikjen fillestare të zjarreve në objektet dhe hapësirat e KMDK SH.A janë siguruar pajisjet zjarrfikëse si në vijim:
 1. Uji, i cili për nga mënyra e derdhjes mund të përdoret me një çurg të plotë,

2. S, Aparat i mbushur me pluhur për fikje te zjarrit, (*janë të mbushura me mjet universal për fikje zjarripluhur për fikjen e zjarrit fillestar*). Si mjet për fikje përdoret pluhuri hidrofob, i cili hidhet me presion dhe ky nuk e përqon rrymën elektrike. Ky pluhur arrin te shuaj zjarrin me ngufatje (largimin e oksigenit nga vendi i zjarrit nën 16%). Si dhe fikjen e instalimeve dhe aparatet elektrike me tension deri më 1000 voltë. Më së miri i fikin materiet djegëse të cilat nuk bëjnë prush.
3. CO₂, Aparatet me mbushje CO₂, (*janë idealë për fikje në zjarreve më të vogla në hapësirë të myllur, veçmas te instalimet elektrike, centralet telefonike, qendrat kompjuterike etj.*)

Neni 42

- 1) Aparatet, instalimet dhe pajisja zjarrfikëse servisothen dhe kontrollohen më së paku njëherë në vjet kur janë vënë në kushte dhome, përkatësisht dy herë në vjet nëse u ekspozohen ndikimeve atmosferike, në pajtim me normativat, standardet dhe udhëzimet teknike të prodhuesit.
- 2) Për servisim, kontrollim dhe testimin, si dhe për matjet dhe kalibrimet e bëra, servisimi i autorizuar përgatit procesverbal në të cilin janë shënuar rezultatet nga aktivitetet e bëra.

Neni 43

- 1) Defektet e pajisjeve dhe instalimeve të përmendura eliminohen në një afat i cili nuk është më i gjatë se dy ditë nga dita e konstatimit të defektit.
- 2) Në raste të jashtëzakonshme për shkaqe objektive ky afat vazhdohet në përputhje me mundësitet e servisit të autorizuar i cili e bën servisimin dhe furnizimin e mjeteve dhe të pajisjeve rezervë si dhe te instalimeve stabile për zbulim automatik /manual dhe për alarmim të zjarrit

Neni 44

Aparatet për mbrojtje nga zjarret dhe instalimet stabile për zbulimin automatik/manual dhe për alarm, duhet të instalohen nëpër objekte, të vendoset në pajtim me normativat, standardet teknike dhe me udhëzimet e me rekomandimet e prodhuesit.

Neni 45

- 1) Aparatet apo instalimet automatike/ manuale për zbulimin dhe alarmim te zjarrit mund te kenë detektorë të ndryshëm: optikë, termikë, jonizues, detektorë flake dhe detektorë për matjen e përqendrimit të gazit në varësi nga rreziqet..
- 2) Sistemet e zbulimin automatik apo manual për alarmimin e zjarrit detyrimisht duhet të sigurohen nga një burim i pavarur i energjisë.

Neni 46

Sistemet manuale dhe automatike për alarm, kontrollohen një herë në vit për verifikim e gjendjes së rregullt të tyre.

Aparatet zjarrfikëse

Neni 47

- 1) Aparatet për fikje të zjarrit vendoset në të gjitha objektet dhe në vende të caktuara të hapura të KMDK SH.A. duhet të renditen në të gjitha vendet kritike e të dukshme dhe ato duhet të shënohen dukshëm me tabelë- Aparate zjarrfikëse dhe mos të zhvendoset.
- 2) Aparatet zjarrfikëse duhet medoemos të vendoset në vend ku nuk ka pengesa dhe shumë shpejtë të mund të shfrytëzohen.
- 3) Lloji dhe sasia e aparatave zjarrfikëse caktohet sipas shkallës së pritshme të zjarrit, sipërfaqes së objektit dhe ngarkesës/potencialit për zjarr.
- 4) Çdo aparat për fikje të zjarrit duhet të shoqërohet me një karton kontrollues me të dhëna të veçanta.

- 5) Në trupin e aparatit për fikje te zjarrit është e vendosur etiketa e cila përshkruan tekstuallish dhe grafikisht mënyrën e përdorimit.
- 6) Etiketa e çdo aparati përmban shenjat e mjetit për fikje me të cilin është mbushur, sasia e mjetit, shkallët e zjarrit për të cilin është paraparë dhe udhëzimi për aktivizim.
- 7) Aparatet zjarrfikëse vendosen në vende të dukshme dhe me qasje të lehtë ose në afërsi të drejtpërdrejtë të vendeve dhe pajisjeve me rrezik të lartë nga paraqitura e zjarrit në një lartësi prej 1,5 m nga dyshemeja deri te dorëza e aparatit zjarrfikës, ndërsa mbi të vendoset tabela me mbishkrim aparati zjarrfikës.

Neni 48

Ne zonat e hapura përgjatë trupit te deponive është i shpërndarë sistemi i ricirkulimit të ujërave nga lagunat, me përjashtim te Deponisë në Mirash, e cila ka sasi te mjaftueshme uji por për përdorimin e të cilin duhet te funksionalizohen pompat.

Neni 49

- 1) Rrjeti i ujësjellësit dhe kyçjet ne rubinet duhet të jenë në qasje në çdo kohë, ata duhet të shënohen me tabelë, te vendosen në atë mënyrë që të pengohet ngrirja ose dëmtimi i tyre.
- 2) Për çdo objekt duhet te kalkulohen këto pajisje sipas njësive te meposhtme:
 - Zorrë/gyp Φ ____ mm, gjatësia ____ m, X ____ copë,
 - gryka e currilit/rubineti me ventil Φ ____ mm, X ____ copë,
 - çelësi me lidhën „C“ ____ copë, dhe
 - çelësi universal për lidhëse - A,B,C 1, X ____ copë

Neni 50

Në deponi, presioni i nevojshëm dhe sasia e ujit sigurohet nga pompat e ricirkulimit të ujit, nga rezervarët e lagunave, por që shtrirja e rrjetit është e kufizuar vetëm brenda trupit të deponive.

Neni 51

- 1) Kontrollimi për të parë a është në rregull e tërë infrastruktura zjarrfikëse duhet të bëhet një (1) herë në vit.
- 2) Kontrolli përfshinë: Aparatet zjarrfikëse, dhe zorrët, grykat e rubinetit dhe ventilet têrthorëza dhe presioni në ta.
- 3) Gjithashtu duhet të bëhet kontrollimi i tokëzimit të aparateve elektrike.
- 4) Kontrolli dhe verifikimi i rregullshmërisë së instalimit rrufepritës bëhet për çdo vjet, ndërsa, sipas nevojës, edhe më shpesh (në rast të dëmtimeve mekanike, shlirimët eventual të pjesëve etj.).

Kontrolli i brendshëm

Neni 52

Kontrollin e brendshëm e bën njësia për kontroll te brendshëm i KMDK SH.A, ose personi i caktuar për këtë punë për mbrojtje kundër zjarreve i ka të drejtat dhe detyrimet vijuese:

1. bën kontroll të têrësishëm për krejt pajisjet dhe mjetet për mbrojtje nga zjarri.
2. e kontrollon ruajtjen, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve për mbrojtje nga zjarri.
3. bën kontrollin në hapësirat tjera për të verifikuar zbatimin dhe realizimin e dispozitiveve dhe masave preventive për mbrojtje nga zjarri, në përputhje me vlerësimin dhe planin për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera dhe në përputhje me Elaboratin për mbrojtje nga zjarret, shpërthimet dhe materiet e rrezikshme.
4. Në bazë të mangësive të vërtetuara në kuptim të mbrojtjes nga zjarri, më së paku njëherë në muaj bën procesverbal (*lajmërim*) për to, dhe në të i paraqet masat dhe afatin përlargimin e mangësive të paraqitura (vërejtjet, rekomandimet, afatin përlargimin e tyre, propozime përsanksione dhe shpërbërblime etj.).

KAPITULLI IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 53

- 1) Të gjithë të punësuarit, klientët dhe operatorët e KMDK SH.A janë të obliguar t'u përbahen dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe t'i zbatojnë masat e parapara për mbrojtje nga zjarri.
- 2) Mosbatimi i dispozitave të kësaj rregulloreje konsiderohet si shkelje serioze dhe atë për rastet si ne vijim:
 1. mospjesëmarrja në zbatimin e masave për mbrojtje nga zjarri, mospjesëmarrja ne evakuimin e të punësuarve dhe mospjesëmarrja në shpëtim.
 2. mospjesëmarrja në fikjen e zjarrit dhe në shpëtimin e pasurisë dhe njerëzve dhe në largimin e pasojave të shkaktuara nga zjarri.
 3. mospasja kujdes për rregullsinë e aparatave, pajisjeve teknike dhe mjeteve për mbrojtje nga zjarri.
 4. mospasja kujdes për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pajisjes personale dhe kolektive të cilën e posedojnë objektet dhe të punësuarit për mbrojtje nga zjarri.
 5. moslargimi ose moslajmërimi i çfarëdo defekti ose dëmtimi të instalimeve elektrike, aparatave elektrike etj. nga të cilat mund të shkaktohet zjarri.
 6. moslajmërimi i të punësuarve dhe mosmarrja e masave urgjente për shpëtim dhe përfikjen e zjarrit në rast të paraqitjes së zjarrit.
 7. moskryerja e detyrimeve lidhur me mbrojtjen nga zjarri nga ana e të punësuarve në hapësirat punuese të KMDK SH.A.
 8. mosrespektimi i urdhreve të udhëheqësit të aksionit për fikjen e zjarrit në rast të paraqitjes së zjarrit.
 9. mosrespektimi i masave për mbrojtje nga zjarri ose shkaktimi i qëllimshëm i zjarrit ose kryerja e sabotimit dhe obstruksioneve nga aspekti i mbrojtjes nga zjarret.


Neni 54

- 1) Për punët të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore do të vlejnë dispozitat ligjore në fuqi.
- 2) Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje është edhe Aneksi I, i cili mund të perditesimi/azhurnohet pa qenë e nevojshme të bëhet plotësim ndryshimi i kësaj rregulloreje.
- 3) Ndryshimi i listës mund të bëhet në varësi të zhvillimeve duke vendosur gjurmët e ndryshimit me nënshkrim dhe vulë ne vedin e ndryshimit

Neni 55

Kjo Rregullore hyn në fuqi me 01 Janar 2019, pas miratimit paraprak të saj nga Bordi i Drejtoreve dhe pas nënshkrimit të saj nga ana e Kryesuesit te Bordit të Drejtoreve në KMDK SH.A.

Kryesuesi i Bordit të Drejtoreve në KMDK SH.A
Lundrim Camaj



Prishtinë, më 25.07.2018

ANEKSIN I

Lista e aparateve, pajisjeve dhe hidrantëve kundër zjarrit, sipas llojit, sasisë, afatit te skadencës dhe vendndodhjes.

Nr	Aparatura/Pajisja	lloji	sasia	vendndodhja	afati i skadencës	vërejtje
1	Aparat zjarrfikës	S-9 kg	6	Prishtine		Krahas tabelave dispeçere
				Mirash		
			1	Landovicë		
				Velekincë		
				Dumnicë		
				Gërlicë		
2	Aparat zjarrfikës	S-6 kg		Prishtine		
			3	Mirash		
			4	Landovicë		
			5	Velekincë		
			2	Dumnicë		
			5	Gërlicë		
	Aparat zjarrfikës	CO2-5kg	3	Prishtine		
				Mirash		
				Landovicë		
			1	Velekincë		
				Dumnicë		
				Gërlicë		
	Aparat zjarrfikës	S-50 kg		Prishtine		
			3	Mirash		
			3	Landovicë		
			3	Velekincë		
			2	Dumnicë		
			2	Gërlicë		
	Aparat zjarrfikës	FM200 5c		Prishtine		
				Mirash		
				Landovicë		
				Velekincë		
				Dumnicë		
				Gërlicë		
	Hidrantë nëntokësorë			Prishtine		pajisje e pakompletuar hidrantësh
				Mirash		
				Landovicë		
				Velekincë		
				Dumnicë		
				Gërlicë		
	Cisterna mobile			Prishtine		
				Mirash		
				Landovicë		
				Velekincë		
				Dumnicë		
				Gërlicë		
	Aparate ne automjete		3	Prishtine		
				Mirash		
				Landovicë		
				Velekincë		
				Dumnicë		
				Gërlicë		